



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 04 Qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 12, nenit 13 dhe nenit 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.04.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME-BUJQËSORE TË KOMUNËS NË ZK-DOBRAJ E VOGËL DHE SMALLUSHË

Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale –tokë bujqësore që gjenden sipas Zonave Kadastrale të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr	Pronar	Zona Kadastrale	Parcela Kadastrale	Kultura	Sipërfaqe për shfrytësim m ²
1	Komuna e Lipjanit	Dobraj e Vogël	P-71409049-00025-1	Bujqësore	6802
2	Komuna e Lipjanit	Dobraj e Vogël	P-71409049-00051-0	Bujqësore	24758
3	Komuna e Lipjanit	Smallushë	P-71409078-01381-1	Bujqësore	154760 pjesë

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale jepen në shfrytëzim në periudhen afatshkurtër prej 10 (dhjetë) viteve, nëpërmjet ankandit publik dhe çmimin fillestar do të

jetë prej 50€ (pesëdhjet euro) për 1ha (hektar) vjetore, për secilën pronë duke u bazuar në vendndodhjen e pronës dhe bonitetin e saj, ndërsa do të kenë mundësi të përfitojnë personat fizik dhe juridik që ofrojnë çmimin më të lartë. Pronat e propozuara janë publikuar brenda afatit ligjor në ueb-faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik 1Nr.463/02-70853 datë 30.12.2025 konformë dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale sipas nenit 1 të këtij vendimi është që sipërfaqet bujqësore nëpërmjet procedurës së ankandit publik t'u jepen në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, që merren me veprimtari bujqësore.

Neni 4

Procedura e vlerësimit të ofertave mund të zhvillohet edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.

Neni 5

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatshkurtër siç përcaktohet në nenin 2 të këtij vendimi, pas parashtimit të kërkesës nga përfituesi i ankandit konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspekcion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-462/01-20093

Lipjan, më 30.04.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi